# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437140**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Alarmon kreu i inteligjencës britanike: 11 Shtatori mund të përsëritet – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/alarmon-kreu-i-inteligjences-britanike-11-shtatori-mund-te-perseritet/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 15:44:59 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 15:44:51 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `322299388cc4d49bbe62fbef7d9d5cb70eae1ef36cd09e4a251fd4e35f172eaf` |
| TEKSTI | `b89dc9d5db386709f29fef84b4b3caae3265df142b914105f25497748fb0f7ef` |
| PAMJA | `206d38c0e9c2de64828c1fb239d20c02611e69905f2b14c46751932ba5c4509e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `792e992f4f87d1c3cac628e17cab93af81a1de350feb7dc0db38c5e72730acd2` |
| E MËPARSHMJA | `afd0e998e4a08f6582b397b570ebee6f868e12ae286feb5d5cf11a51834898a5` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/792e992f4f87d1c3cac628e17cab93af81a1de350feb7dc0db38c5e72730acd2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bota mund të përballet me një 11 Shtator tjetër dhe Shërbimet Britanike të Inteligjencës por edhe ato botërore nuk duhet të përqëndroehn vetëm tek kërcënimet e të kaluarës , por duhet të jenë të përgatitura për një goditje të re strategjike, të ngjashme me sulmet e 11 Shtatorit 2001.

Paralajmërimin vjen nga drejtori i përgjithshëm i MI5, Ken Mçallum, në një opinion të publikuar të premten, në kuadër të 25-vjetorit të sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara.

Mçallum theksoi se mësimi më i rëndësishëm nga 11 Shtatori është se goditja e ardhshme strategjike, pikërisht për shkak të natyrës së saj, nuk do të ngjajë domosdoshmërisht me atë të mëparshmen.

Sipas tij, shërbimet e sigurisë duhet të mësojnë nga sulmet e së kaluarës, por njëkohësisht duhet të shmangin rrezikun e përgatitjes së përsosur për të luftuar një armik, duke përdorur metodat dhe objektivat e së kaluarës. “E vërteta e pakëndshme është se goditja e ardhshme strategjike mund të jetë tashmë duke marrë formë diku ku ne ende nuk po shikojmë”, shkroi kreu i MI5.

Mçallum paralajmëroi se, megjithëse Al-Kaeda është dobësuar ndjeshëm, grupi mbetet një kërcënim, ashtu si edhe synimi i tij dhe i organizatave të tjera militante për të kryer sulme me një numër të madh viktimash.

Ai iu referua edhe një komploti islamist të parandaluar së fundmi në Britaninë e Madhe, i cili kishte si objektiv kryerjen e sulmeve me armë ndaj komunitetit hebre në qytetin e Mançesterit.

5 Zgjedhjet vendore/ Blinin vota në Tiranë në favor të një partie politike...

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

Por, sipas drejtuesit të MI5, kërcënimet ndaj Britanisë nuk kufizohen vetëm te terrorizmi. Ai vuri në dukje rritjen e agresionit të mbështetur nga shtete të huaja, nga aktet e sabotimit të kryera përmes personave të rekrutuar nga rrjetet kriminale, deri te sulmet kibernetike kundër infrastrukturës kritike, përfshirë centralet elektrike.

“Ne nuk mund të presim goditjen e radhës për të zbuluar se kush e zotëron dobësinë, kush ka autoritetin për të vepruar apo kush duhej të merrte telefonin”, paralajmëroi Mçallum.

Në mesazhin e tij, kreu i MI5 tha se viktimave të 11 Shtatorit dhe atyre që mund të bëhen viktima të një sulmi të ardhshëm nuk u detyrohet vetëm kujtesa, por edhe përgatitja, qëndrueshmëria dhe aftësia për t’u përshtatur përpara se të ndodhë goditja e radhës.

#11shtatori #Britanike #inteligjenca #VizionPlus

**Taulant Halili**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



BOTA

**Tragjedi! Përmbyset anija me pasagjerë,...**

Xhuljana Zhuleku · 6 orë më parë



BOTA

**Zjarr masiv në Kroaci, evakuohen 230...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 19:36



BOTA

**Trump: Lufta me Iranin do të...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 18:51



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.